

TË FUNDIT

- Vendosi LDK: Ky është kandidati për kryetar komune të Prizrenit
- Shkarkimi i Agim Veliut: Skender Hyseni akuza të rënda ndaj Abdixhikut
- Melinda provokuese edhe në shtëpi
- Vjen lajmi i shumpritur: Sallat e dasmave hapen nga kjo datë
- Rastësi apo planifikim?! Nesër kur zhvillohet takimi Kurti – Vuçiq, në Bruksel edhe njeriu më i fuqishëm i botës Joe Biden



Vritet një 44 vjeçar, arrestohet i dyshuari

08/06/2021 / 10:25 / Kryesore, Lajme

Të shtëna me armë zjarri janë shënuar rreth orës 08:30 të mëngjesit të sotëm në Peqin, ku i vdekur ka mbetur një 44 vjeçar.

Sipas njoftimit nga Policia e Shtetit, rasti ka ndodhur pas një konflikti për motive të dobëta, ku shtetasi L. B., 36 vjeç, banues në Gjocaj, ka plagosur me armë zjarri shtetasin Y. Xh., 44 vjeç, banues në fshatin Pajov, i cili si pasojë e plagëve ta marra ndërroi jetë në spitalin e Peqinit.

“Reagimi i menjëhershëm i Policisë bëri të mundur identifikimin e autorit, lokalizimin e vendndodhjes dhe pas disa minutash ndjekjeje nga shërbimet e Policisë u bë e mundur kapja dhe prangosja e autorit të dyshuar, së bashku me armën e zjarrit pistoletë”, thuhet në njoftim.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.